



2 mars, 2018

I nderuar Z. Ministër i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi,

Sot kam pasur një takim me Besa H. Zagragja, inspektore nga MASHT-it, në objektin kryesorë të shkollës sonë. Gjatë bisedës sonë, kuptova se mund të ishte e dobishme t'ju informonim për një vendim që morëm në lidhje me tre ditët e pushimit të shpallura nga MASHT-i si rrjedhojë e motit të ftohtë. Ne anuluar mësimin në shkollën tonë të mërkurën, por e ri-filluam atë të enjten dhe të premten dhe do të shpjegojmë arsyetimin tonë më poshtë për të ju informuar mbi këtë vendim. Nuk kishte asnjë qëllim si shenjë e mosrespektit të këtij vendimi nga ana jonë. Si udhëheqëse e një shkolle ku përpiqemi të përgatisim studentët për universitete të nivelit të lartë dhe gjithashtu të plotësojmë kërkesat e MASHT-it, këto vendime mund të jenë të vështira dhe të sikletshme për ne. Ne nuk posedojmë detaje të shkruara për të sqaruar vendimin tonë, sidoqoft në këtë dokument të shkruar do të gjeni arsyet e këtij vendimi. Kështu, do të doja të përfitoj nga ky rast për t'ju falënderuar për durimin dhe mirëkuptimin tuaj, ndërsa unë ndaj me ju procesin e vendimit tonë.

1. Sipas marrëveshjes sonë të akreditimit me AdvancED ne jemi të detyruar të ofrojmë mësim për 180 ditë në një vit shkollor. Vitin e kaluar kemi marrë një njoftim paralajmërues për përmirësim nga AdvancED duke na detyruar që të shtojmë ditët mësimore në kalendarin tonë. Kështu, në qoftë se do të humbisnim ditë të tjera, do të ishte e detyrueshme që ne të zëvendësojmë këto ditë dhe duke qenë shumë të zënë me një sërë projektesh të rëndësishme, duke përfshirë ndërtimin e objektit të ri dhe planifikimin për lëvizjen tonë në shtator, do të ishte një sfidë e madhe për të ofruar ditë shtesë të shkollës në një të shtunë dhe frekuentimi do të ishte i ulët. Përveç kësaj, ofrimi i një serie të orëve të së shtunës do të krijonte vështirësi për familjet që nuk kanë kujdes cilësor për fëmijët ndërsa janë larg me punë. Veçanërisht familjet ndërkombëtare e kanë të vështirë të gjejnë kujdestar për fëmijët e tyre duke pranuar një njoftim aq të shpejtë, vetëm disa orë paraprakisht.
2. Ne e kuptojmë se kur MASHT-i bën thirrje që mësimi të ndërprehet, ajo parashihet dhe analizon situatën për të gjithë Kosovën dhe ka shkolla dhe transporte të cilat nuk janë mjaft të ngrohta. Megjithatë, duke qenë se ne ndodhemi në qendër të qytetit të Prishtinës dhe kemi furgona të reja dhe ngrohje qendrore, ne ndjejmë se studentët tanë do të mbrohen nga ftohtësia ekstreme. Për fat të mirë, temperatura u ngrit të enjten dhe të premten dhe ne hapëm shkollën të enjten dhe premten. Të enjten kishim vetëm 35 nxënës që mungonin nga klasat 1-9 nga totali i 470 nxënësve.
3. Për shkak se shumë nxënës tanë janë duke u përgatitur për regjistrimet e tyre në universitete ndërkombëtare, kjo është një kohë veçanërisht e zënë e vitit. Në maj, 25 studentë do të i nënshtrohen provimeve AP (Advanced Placement) të cilat vlerësohen nga jashtë. Nëse nxënësit i kalojnë me rezultat të mirë këto testime, këto kurse mësimore do të i plotësojnë vlersimet e kurseve të caktuara në universitet duke i pasur kredit që do të merrnin në një universitet amerikan në vitin e tyre të parë. Ne kemi 15 nxënës serioz të cilët kanë aplikuar në universitete prestigjioze dhe ata do të duhet të provojnë vazhdimësinë dhe suksesin e tyre në shkollë për të kërkuar bursa të veçanta në qershor.
4. Ne aktualisht jemi duke përgatitur një trajnim për zhvillim profesional "Samiti i të mësuarit në Kosovë" organizim që do të ndodh më 31 mars - 1 prill në të cilin do të profesionistë



ndërkombëtarë të arsimit, përfshirë Robyn Hansen, ish-president i Shoqatës së Principatave Kombëtare në Amerikë dhe ekipi udhëheqës akademik i ASK-së, do të ofrojnë diskutime dhe punëtori për të gjithë edukatorët në Kosovë. Ne kemi zgjedhur të organizojmë këtë eveniment në fundjavë në mënyrë që mësuesit e shkollave publike të mund të marrin pjesë lehtësisht; megjithatë, kjo e bën edhe më të vështirë për mësuesit e ASK-së të punojnë shtesë edhe në fundja për të mbuluar "ditët e dëborës".

5. Ne po përgatitemi për të hyrë në një ndërtesë të re në shtator dhe për të menaxhuar të gjitha aspektet e operacioneve, caktimin, buxhetin dhe regjistrimin e nxënësve. Kjo procedurë kërkon një proces planifikimi me rëndësi dhe kujdes të veçant, në mënyrë që ne të planifikojmë hapjen e shkollës në shtator.
6. Gjatë datave 16 dhe 17 mars, ne do të kemi mbledhjet individuale me prindër, që i quajmë konferenca prind-mësues-nxënës, dhe nëse shumë ditë mësimore janë ndërprerë, nuk do të kemi mësim kuptimplotë ose aftësi për krijim e raporteve për këto mbledhje. Kjo është koha e vitit kur nxënësit dëshmojnë më së shumti të mësuarin e tyre dhe qëndrueshmëria dhe vazhdimësia e mësimin është shumë e rëndësishme.
7. Ndërsa kemi shumë mësues ndërkombëtarë dhe familje që organizojnë udhëtimet e tyre kohë, nuk është e lehtë për ne të ndryshojmë orarin e pushimit të pranverës në mënyrë që të zëvendësojmë mësimin për ditët e shpallura si ditë pushimi. Mundësia e vetme do të ishte që ne të shtonim si ditë mësimi ditët e shtuna për të zëvendësuar ditët ose për të zgjatur vitin shkollor përtej 23 qershorit. Ne kemi mësues që vetëm se kanë blerë bileta për rikthimin e tyre në vendlindje nga data 24 qershor.

Unë mendoj se ju mund të shihni nga kjo listë e shpjegimeve, se ka pasur shumë diskutime nga ekipi i udhëheqësisë pas vendimit tonë të fundit për të hapur shkollën dje dhe sot. Përsëri, ju falënderojmë për kohën tuaj duke lexuar këtë dhe dëshirojmë që të dini se ne jemi shumë të hapur për t'u takuar me ju për të diskutuar ndonjë plan të ardhshëm për vendimmarrje lidhur me mbylljen e shkollës gjatë sezonit të dimrit.

Sinqerisht,

Znj. Shannon Bruce Ramaka

P.S. Më poshtë gjeni postimin ku njoftuam se mësimi nuk do të zhvillohet të mërkurën.



American School of Kosovo
Educating the leaders of tomorrow. For a better future

**SHKAKU I MOTIT TË FTOHËT NESËR NUK DO TË ZHVILLOHET PROCESI
MËSIMOR
28 shkurt 2018**

Ju lutemi të informoheni se ne do të duhet të "zëvendësojmë" këtë ditë pushimi në të ardhmen dhe mbi datën se kur do të ndodh kjo do ju informojmë më vonë në pranverë.

Shpresojmë të shijoni ditën e nesërme! Qëndroni në ambient të ngrohët!

Shannon Bruce Ramaka
Head of School

